

**VENDIM**  
**Nr. 177, datë 25.2.2015**

**PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN “RSM”, NË SHTABIN E TRAJNIM-KËSHILLIMIT DHE NDIHMËS, NË KUADËR TË INICIATIVËS SË KARTËS SË ADRIATIKUT, NË AFGANISTAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, e 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dërgimin me mision të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin “RSM”, të përbërë nga 2 (dy) ushtarakë, në Shtabin e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës, në Mazar-e-Sharif, në Afganistan, në kuadër të iniciativës së Kartës së Adriatikut.

2. Misioni i personelit që do të marrë pjesë është mbështetja dhe dhënia e kontributit në funksione të ndryshme në Shtabin e Trajnimi-Këshillimit dhe Ndihmës, në operacionin e NATO-s “RSM”, në Afganistan, në kuadër të iniciativës së Kartës së Adriatikut.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 5 (pesë) vjet, afat i cili fillon të llogaritet nga data 1 mars 2015. Periudha e qëndrimit në mision për çdo përfaqësues do të jetë me sistem rotacioni në çdo 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për marrjen dhe dorëzimin e detyrës dhe vonesa të transportit strategjik për ndërrimin me kontingjentin e radhës.

4. Venddislokimi i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të jetë në Shtabin e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës, në Mazar-e-Sharif, në Afganistan.

5. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

dh) transport;

e) transportimin e individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

ë) aktivitete social - kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;

f) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Transporti i personelit që do të dërgohet me mision në Afganistan, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t’u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanderia të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy- ose shumëpalëshe ku pala tjetër merr përsipër të përballojë këto shpenzime.

7. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

9. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**